

SC-PR-37 Terms of Reference (ToR)-ALB 2025 0296

Thirrje për 2(dy) lehtësuese të komunitetit Rom për të zhvilluar aktivitete me fëmijët dhe prindërit në Bashkitë Tiranë & Gjirokastrë.

26-11-2025

Terma Reference (ToR)

Informacion mbi Save the Children

Save the Children është organizata globale kryesore e pavarur për fëmijët. Save the Children beson se çdo fëmijë meriton një të ardhme. Në mbarë botën, ne punojmë çdo ditë për t'u dhënë fëmijëve një fillim të shëndetshëm në jetë, mundësinë për të mësuar dhe mbrojtje nga dëmtimi. Kur ndodhin kriza dhe fëmijët janë më të cenueshëm, ne jemi gjithmonë ndër të parët që reagojmë dhe të fundit që largohemi. Ne sigurojmë që nevojat unike të fëmijëve të plotësohen dhe zërat e tyre të dëgjohen. Ne sjellim rezultate të qëndrueshme për miliona fëmijë, përfshirë ata më të vështirë për t'u arritur.

Vizioni ynë: Një botë ku çdo fëmijë gëzon të drejtën për mbijetesë, mbrojtje, zhvillim dhe pjesëmarrje.

Misioni ynë: Të frymëzojmë ndryshime në mënyrën se si bota trajton fëmijët dhe të arrijmë ndryshime të menjëhershme dhe të qëndrueshme në jetën e tyre.

Vlerat tona: Llogaridhënie, ambicie, bashkëpunim, kreativitet dhe integritet.

Konteksti

Projekti "Fëmijët Romë Mësojnë, Ulja e Pengesave për Arsimin dhe Zhvillimin" synon të ndërtojë një model të bazuar në perspektivën e të drejtave të fëmijëve dhe të adresojë çështjet e aksesit, regjistrimit dhe pjesëmarrjes në edukimin cilësor në fëmijërinë e hershme dhe arsimin fillor për djemtë dhe vajzat rome, duke mbështetur prindërit dhe familjet e tyre të ndajnë jetën komunitare dhe të promovojnë kulturën rome në lagjet e Tiranës dhe Gjirokastrës.

Ky projekt është pjesë e "Veprimit Rajonal të BE-së për Arsimin e Romëve: Mbështetje dhe Mundësi të Shtuara për Studentët Romë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi (RARE) faza II", financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Fondi për Arsimin e Romëve (REF Romania).

Objektivi

Në kuadër të projektit, Save the Children në Shqipëri kërkon 2 (dy) Lehtësuese të komunitetit Rom, nga një për secilën bashki (Tiranë & Gjirokastrë), të cilat do të zhvillojnë aktivitete për fëmijët/prindërit romë/ jo romë në kuadër të zhvillimit në fëmijërinë e hershme dhe aksesit në arsimin bazë. Ky programi " Historia Juaj" synon të inkurajojë prindërit të lexojnë libra dhe përralla me fëmijët e tyre, duke kontribuar në zhvillimin gjuhësor, numerik dhe kognitiv të fëmijëve romë dhe jo-

romë, si dhe në forcimin e aftësive të shkrim-leximit në çdo kopsht të projektit, ku do të krijohet një hapësirë e dedikuar me libra/bibliotekë.

Vendndodhja

Lehtësueset e Programit “ Historia Juaj” do të punojnë në zonën e Shkozës në Tiranë dhe në zonën Zinxhiraj në Gjirokastrë.

Shërbimet që do të ofrohen

- Zhvillimi i sesioneve praktike me prindërit dhe fëmijët në zhvillimin e lojrave interactive (të paktën 4 aktivitete në muaj) sipas një plani pune tematik të hartuar në bashkëpunim me kopshtet/qendrat komunitare në Tiranë (zona Shkozë) dhe Gjirokastrë (komuniteti Zinxhiraj), për të mbështetur aksesin në lodra edukative cilësore dhe për të nxitur zhvillimin e shëndetshëm fizik, kognitiv, gjuhësor dhe social të fëmijëve romë dhe jo-romë.
- Zhvillimi i sesioneve praktike të leximit të librave me përralla si pjesë e programit “Historia Juaj” (të paktën 4 aktivitete në muaj) sipas një plani pune tematik të hartuar në bashkëpunim me kopshtet/qendrat komunitare në Tiranë (zona Shkozë) dhe Gjirokastrë (komuniteti Zinxhiraj), me synim forcimin e aftësive të shkrim-leximit tek fëmijet.
- **Përgatitja e raportit mujor** lidhur me aktivitetet e organizuara me fëmijët (duke përfshirë foto + listën e pjesëmarrjes së prindërve + listën e shpërndarjes së lodrave/librave tek fëmijet).

Kualifikimet e kërkuara

- Preferohet të jetë pjesë e komunitetit Rom – 35 pike
- Referenca të mira nga liderët e komunitetit rom/ Organizate romë – 30 pike
- Aftësi të mira në shkrim dhe lexim të gjuhës shqipe – 25 pikë
- Eksperiencë e mëparshme pune me komunitetin rom dhe familjet e tyre- 15 pikë

Afatet

- Data e fillimit: 01-01-2026
- Data e përfundimit: 31-05-2026
- Pagesa mujore sipas politikave të Save the Children, me zbritje 15% për taksat.

Aplikimi

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë CV, letër interesi, reference nga lideri i komunitetit brenda datës **05-12-2025, ora 17:00**.

Dorazi në adresën: Save the Children in Albania National Office Rr. Mihal Popi, Ndertesa 7, ish Pallatet 1 Maji, Vila “Lami”;

OSE

✉ info.albania@savethechildren.org Subjekti: Thirrje 2 (dy) lehtësuese të komunitetit Rom për të zhvilluar aktivitete me fëmijët dhe prindërit në Bashkitë Tiranë & Gjirokastrë.

The project "EU Regional Action for Roma Education: Increased Education Support and Opportunities for Roma Students in the Western Balkans and Turkey (RARE), phase II" is funded by the European Commission through the Directorate-General for Enlargement and the Eastern Neighbourhood and is implemented by REF Romania and REF Serbia.



**Funded by
the European Union**